



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHITËTJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME




СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

HULUMTIM MBI PERCEPTIMIN E QYTETARËVE LIDHUR ME ZBATIMIN E KODIT TË ETIKËS NGA DEPUTETËT





ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHËTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

IMPRESUM:

Titull: Hulumtim mbi perceptimin e qytetarëve lidhur me zbatimin e Kodit të etikës nga deputetët

Botues: Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN)

Rreth botuesit: Drejtoreshë Ekzekutive e QMN-së, Neda Maleska Saçmaroska

Autor: Ekipi i QMN-së

Redaktor: Neda Maleska Saçmaroska

Dizajni: Marko Danailovski

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2023

Ky publikim është përgatitur nga Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN) në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP) i cili financohet nga Qeveria e Zvicrës dhe zbatohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN). Përmbajtja e publikimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Qeverisë së Zvicrës.



Përmbajtja

Përmbledhje e gjetjeve kryesore	3
Hyrje	4
Konteksti	5
Gjetjet e kërkimit	7
I. Perceptimi i qytetarëve për sjelljen e deputetëve	7
II. Perceptimi i qytetarëve për sjelljen e deputetëve në raport me shkallën në të cilën anë/nuk janë të njohur me punën e Kuvendit dhe punën e deputetëve	24
Rekomandime	33
Shtojca 1 – Metodologjia e hulumtimit	34
Qasja metodologjike	34
Struktura demografike e të anketuarve	36



Përmbledhje e gjetjeve kryesore

- 42,5% e të anketuarve deklaruan se nuk janë të njohur me punën e deputetëve, ndërsa 25,3% deklaruan se janë të njohur me punën e deputetëve.
- Vetëm 12% e të anketuarve besojnë se deputetët u përmbahen standardeve etike dhe kodeve të sjelljes (nga përgjigjet e grumbulluara, 1,8% e të anketuarve besojnë se deputetët u përmbahen plotësisht atyre ndërsa 10,5% u përmbahen atyre deri në një shkallë të caktuar). Kjo tregon nevojën që deputetët të rrisin përpjekjet për ndërtimin e besimit ndaj qytetarëve përmes kryerjes së ndërgjegjshme dhe të plotë të funksionit të tyre parlamentar dhe përfaqësimit të interesave publike.
- Rreth 63% e të anketuarve besojnë se deputetët nuk respektojnë as standardet etike dhe as kodin e sjelljes.
- 50% e të anketuarve theksuan se mbajtja e premtimeve të bëra nga deputetët ndaj qytetarëve duhet të jetë fokusi/prioriteti kryesor i deputetëve.
- Shumica e të anketuarve besojnë se gjëja më e rëndësishme për një deputet është të jetë i pakorruptueshëm, ndërsa rreth 31% e qytetarëve mendojnë se komunikimi më i shpeshtë me qytetarët mund të rrisë efikasitetin e punës së deputetit.
- 42% e qytetarëve besojnë se një nga sfidat më të rëndësishme me të cilat përballen deputetët në kryerjen e detyrave të tyre është presioni nga partitë e tyre politike përkatëse .
- Një sfidë tjetër e rëndësishme për deputetët është të bindin publikun se ata respektojnë standardet etike dhe kodet e sjelljes.
- Sipas të anketuarve, deputetët rrallë pranojnë gabimet e tyre dhe rrallë marrin përgjegjësi për veprimet e tyre, dhe zyrtarët e zgjedhur/emëruar kujdesen më së paku për shpenzimin e përgjegjshëm dhe me kosto efektive të fondeve dhe burimeve publike .
- 64% e qytetarëve të anketuar do të donin të shihnin masa më drastike që ndërmerren në trajtimin e shkelësve të standardeve morale (27% vlerësojnë se deputetët duhet të hiqen nga detyra, 27% vlerësojnë se duhet të përballen me ndjekje penale dhe 10% besojnë se deputetët duhet të përballen me burg)



Hyrje

Në dekadat e fundit, ka pasur presion në rritje mbi parlamentarët dhe funksionarët e zgjedhur në mbarë botën, për të demonstruar standarde të larta morale dhe për të forcuar besueshmërinë e tyre etike. Kjo është kryesisht rezultat i skandaleve të shumta që kanë dëmtonuar besimin e publikut në institucionet politike dhe politikanët. Në mars të vitit 2011, gazeta britanike "The Guardian" kreu një sondazh me 5,000 votues nga pesë vende evropiane (Franca, Gjermania, Polonia, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar), që parashtroi, ndër të tjera, pyetjen në vijim: "Deri në çfarë mase u besoni politikanëve, pavarësisht nga përkatësitë e tyre politike, se sillen me ndershmëri dhe integritet?" Rezultatet e sondazhit zbuluan se vetëm 9% e të anketuarve u përgjigjën se ata "plotësisht", përkatësisht, "mjaftueshëm" u besojnë politikanëve, ndërsa 89% e lartë thanë "jo shumë" ose nuk u besojnë "aspak".¹ Përgjigjet reflektuan përgjigje të ngjashme në të pesë vendet.

Votuesit presin që funksionarët e tyre të zgjedhur të respektojnë ligjin si kushdo tjetër dhe të udhëheqin me shembull kur bëhet fjalë për etikën dhe integritetin profesional. Në këtë drejtim, parlamenti është përpjekur të përmbushë pritjet e votuesve, duke kuptuar se shpërfillja e tyre do të shërbente vetëm për të minuar më tej besimin e publikut në shtetin, institucionet dhe politikanët. Mekanizmat për arritjen e kësaj në përgjithësi konsistojnë në: mbajtjen e individëve përgjegjës brenda rregullave ekzistuese dhe miratimin e 'kodeve të etikës' ose 'kodeve të sjelljes'. Këto kode përpiqen jo vetëm të japin udhëzime dhe drejtim, por edhe të vendosin standarde të sjelljes dhe të veprimtimit për situatat që ekzistojnë brenda "zonës gri" midis ligjit dhe sjelljes së pranueshme. Natyrisht, shumica e politikanëve nuk kanë nevojë për kodet e sjelljes për t'i detyruar ata të veprojnë moralisht - por siç ndodh shpesh, shumica paguan çmimin për sjelljen e pakicës. Kodet ndihmojnë në drejtimin dhe interpretimin e detyrimeve specifike kur kanë të bëjnë me rrethanat të papërcaktuara ose më komplekse siç janë ryshfeti, konflikti i interesit dhe transparenca financiare.

Sigurisht, kodet nuk mund të jenë një mbrojtje për gjithçka që konsiderohet jo-etike në politikë, por ato shërbejnë si një udhëzues dhe sistem mbështetës për parimet e qeverisjes së mirë. Kodet janë më efektive kur ato ndërtohen mbi një kulturë politike në të cilën integriteti, transparenca dhe llogaridhënia vlerësohen shumë. Asnjë ligj ose kod sjelljeje nuk mund të parandalojë synimet individuale për të "mashtuar sistemin" ose për të thyer rregullat, por ato ofrojnë udhëzime për të vepruar me ndershmëri dhe integritet në përputhje me pritjet e votuesve.

¹ <https://www.theguardian.com/news/datablog/2011/mar/14/europe-poll-icm?intcmp=239#data>



Konteksti

Qeverisja e mirë, në drejtim të menaxhimit të institucioneve shtetërore, nënkupton udhëheqjen e proceseve, monitorimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të angazhimeve strategjike, por edhe menaxhimin efikas dhe efektiv të fondeve dhe burimeve publike. Qeverisja kryhet sipas parimeve të dakorduara, në lidhje me kuadrin rregullator dhe me respektin e rrjetit kompleks të vlerave, standardeve dhe praktikave. Qeverisja mbështetet nga një sistem i përbashkët i etikës, i cili mbulon një gamë të gjerë subjektsh në institucionet e shtetit, por edhe në shoqërinë në tërësi. Kjo kërkon krijimin dhe ruajtjen e vlerave të caktuara dhe një kulturë të sjelljes së duhur, si dhe transformim të caktuar në drejtim të arritjes së standardeve më të larta dhe sjelljes etike. Përveç kësaj, sistemi i etikës në kontekstin e qeverisjes së mirë është një masë e butë, e cila kërkon të plotësojë sistemin formal të rregullimit. Normat dhe standardet etike tregojnë sjelljen e pritshme nga zyrtarët e zgjedhur, përfshirë deputetët, në rastet kur veprimet nuk janë të rregulluara me ligj, por paraqesin një aspekt të rëndësishëm të qeverisjes.

Besueshmëria është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për qeverisjen në sektorin publik. Fitimi i besimit të qytetarëve është jetik për një qeverisje të mirë. Opinioni publik është forca më e fuqishme në një shoqëri demokratike dhe mund të ndihmojë në arritjen e standardeve më të larta të sjelljes morale midis politikanëve, si dhe të nxisë vendimmarrje më të mirë.

Zbatimi i standardeve etike për funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar, si një mjet i butë, gjithashtu ka një rol të fortë në luftën kundër korrupsionit. Duke marrë parasysh se deputetët pasqyrojnë prioritetet e njësive të tyre zgjedhore, rëndësia e sjelljes dhe veprimeve të tyre ndikon shumë në qëndrimin e të gjithë funksionarëve të tjerë ndaj funksioneve politike, si dhe ndaj pronës shtetërore, fondeve dhe burimeve publike.

Ky studim mbi perceptimin publik të shkallës së respektimit të standardeve etike në mesin e deputetëve u përgatit në korrelacion me mjetet e propozuara për përmirësimin e sistemit të etikës parlamentare. Ky hulumtim shqyrton sistemin e vlerave mbi të cilat bazohen pritjet e qytetarëve, në lidhje me veprimet dhe sjelljen e përfaqësuesve të tyre. Ky studim synon të verifikojë nëse vlerat dhe parimet themelore morale sipas të cilave qytetarët vlerësojnë përfaqësuesit e tyre, korrespondojnë me parimet dhe standardet ndërkombëtare të qeverisjes së mirë.



7 parimet e jetës publike², të njohura edhe si parimet e Nolan, udhëhoqën pyetjet e anketës të paraqitura për këtë projekt kërkimor. Parimet e Nolanit përcaktojnë kornizën mbi të cilën bazohen shumica e kodeve etike ose kodeve të sjelljes për funksionarët publikë. Këto parime janë: puna për interesin publik, integriteti, objektiviteti, llogaridhënia dhe përgjegjësia, transparencja, ndershmëria dhe udhëheqja. Pyetjet e anketës u konceptuan sipas këtyre fushave kryesore, por u mor parasysh edhe përmbajtja e Kodit ekzistues të sjelljes etike të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Rezultatet e këtij hulumtimi synojnë të tregojnë nivelin e besimit të qytetarëve tek të zgjedhurit e tyre, të eksplorojnë vlerat që duhet të udhëheqin dhe menaxhojnë sjelljen e deputetëve dhe të shërbejnë si argument për përmirësimin e mëtejshëm të mekanizmave për qeverisje të mirë për të gjitha nivelet e qeverisjes, duke përfshirë edhe degën legislative.

² <https://www.gov.uk/government/publications/the-7-principles-of-public-life/the-7-principles-of-public-life--2>




Gjetjet e kërkimit

I. Perceptimi i qytetarëve për sjelljen e deputetëve

Pyetja e parë i referohet shkallës në të cilën të anketuarit janë të njohur me punën e Kuvendit dhe deputetëve. Përgjigjet për këtë pyetje janë të detajuara në grafikun e mëposhtëm (Grafiku 1). 25.3% e të anketuarve deklaruan se janë të njohur me punën e deputetëve (përgjigjet e grumbulluara për shkallën 4 - jam disi i njohur dhe 5 - jam plotësisht i njohur u morën parasysh), ndërsa 42.5% e të anketuarve deklaruan se nuk janë të njohur me punën e deputetëve, (përgjigjet e grumbulluara për shkallën 1 - nuk jam i njohur aspak dhe 2 - jam disi i panjohur u morën parasysh). Përafërsisht 32% e të anketuarve dhanë një vlerësim prej 3, duke pretenduar se nuk janë as të njohur as të panjohur me punën e deputetëve. Nuk ka dallime statistikisht të rëndësishme në përgjigjet e të anketuarve sipas vendbanimit të tyre (urban 26%; rural 25%).

Duke shqyrtuar përgjigjet e të anketuarve përmes prizmit të karakteristikave demografike, *burrat kur krahasohen me gratë, ata me arsim të lartë kur krahasohen me ata me nivel më të ulët arsimor dhe ata që i përkasin grup-moshës "mbi 55 vjeç" kur krahasohen me grup-moshat e tjera, kanë më shumë gjasa të deklarojnë ose të pohojnë se janë të njohur me punën e deputetëve.* Duke marrë parasysh statusin e punës së të anketuarve, *punonjësit në organizatat joqeveritare dhe punonjësit në sektorin publik janë më të njohurit me punën e Kuvendit dhe deputetëve.*

Grafiku 1. (P1). Sa jeni të njohur me punën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV) dhe deputetëve?



Pyetjet kishin pesë përgjigje të mundshme, në shkallën nga 1 deri në 5, ku 1 është "Nuk jam i njohur" dhe 5 është "Jam i njohur". Prandaj, grumbullimi i përgjigjeve 1 dhe 2 tregohet, si të pa njohur me



punën e deputetëve, 3 mbetet si neutral (as i njohur as i panjohur), ndërsa 4 dhe 5 janë përgjigje përmbledhëse të njerëzve të njohur dhe njohës të punës së deputetëve në Kuvendin e RMV-së.

Përcaktimi i shkallës së njohjes së të anketuarve me punën e deputetëve në Kuvend është i rëndësishëm jo vetëm për përcaktimin e besueshmërisë së përgjigjeve, por edhe për të bërë një krahasim midis pikëpamjeve të të anketuarve që janë të njohur me punën e deputetëve kundrejt atyre që nuk janë të njohur. Siç pritej, të anketuarit që kualifikohen si neutralë-përkatësisht, ata që nuk janë as të njohur as të panjohur me punën e deputetëve-shprehën pikëpamjen se deputetët as i respektojnë dhe as nuk i respektojnë standardet etike dhe rregullat e sjelljes në një shkallë të konsiderueshme. Është e rëndësishme të theksohet se *një e pesta (21%) e të anketuarve, të cilët ndjekin punën e deputetëve, theksojnë se deputetët respektojnë standardet etike dhe rregullat e sjelljes (përgjigjet e grumbulluara- "i respektojnë plotësisht" në 5% dhe "disi i respektojnë" në 16%). Kjo përqindje është gati 4 herë më e ulët në mesin e të anketuarve që nuk janë të njohur me punën e deputetëve.* Në përgjithësi, sa më pak e kuptojnë qytetarët punën e Kuvendit dhe të deputetëve, aq më pak besim kanë në përmbushjen e detyrave të tyre parlamentare. Kjo nënvizon nevojën për të ndërtuar besimin duke sjellë punën dhe kompetencat e Kuvendit dhe deputetëve më afër qytetarëve.

Pothuajse 14% e të anketuarve që nuk e dinë-gjegjësisht, nuk mund të vlerësojnë nëse janë të njohur me punën e deputetëve- nuk mund të përgjigjen me siguri nëse deputetët respektojnë apo jo standardet etike dhe kodet e sjelljes. Për më tepër, në lidhje me të anketuarit që u përgjigjën se *nuk janë të njohur me punën e deputetëve, 6% e tyre gjithashtu nuk e dinë nëse deputetët respektojnë standardet etike.*

Kryqëzimi i të dhënave për shkallën e njohjes me punën e deputetëve, në krahasim me mendimin e qytetarëve për shkallën e respektimit të standardeve etike, është detajuar në pjesën e dytë të këtij raporti.


Pyetja e dytë shqyrton perceptimet e deputetëve për respektimin e standardeve etike dhe kodeve të sjelljes. Parimet etike, rregullat dhe standardet e sjelljes së deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë rregullohen me Kodin për sjelljen etike të deputetëve. Qëllimi i kodit është të rrisë besimin e qytetarëve dhe publikut në vlerat themelore dhe integritetin e deputetëve si individë dhe Kuvend, si organ përfaqësues i qytetarëve të Maqedonisë së Veriut dhe autoritet mbi pushtetin legjislativ. Përkundër faktit se sjellja e pritshme e deputetëve është e rregulluar me dokumentin e lartpërmendur, deputetët ende luftojnë për të bindur publikun në besueshmërinë dhe profesionalizmin e tyre.



Siç është detajuar në Grafikun 2, më poshtë, vetëm 12% e të anketuarve besojnë se deputetët në Maqedoninë e Veriut respektojnë standardet etike dhe rregullat e sjelljes (përgjigjet e grumbulluara për "i respektojnë plotësisht" arrijnë në 1.8% dhe "disi i respektojnë" arrijnë në 10.5% të të anketuarve). Rreth 21% e të anketuarve kanë një qëndrim neutral, domethënë, ata theksuan se deputetët as i respektojnë dhe as nuk i respektojnë standardet etike dhe kodet e sjelljes në një masë të konsiderueshme³.

Rreth 63% e të anketuarve besojnë se deputetët nuk respektojnë standardet etike dhe rregullat e sjelljes (përgjigjet e grumbulluara për "disi i respektojnë" arrijnë në 23.5% dhe "nuk i respektojnë aspak" arrijnë në 39.8%).

Grafiku 2. (P2) Në përgjithësi, sa mendoni se deputetët në vendin tonë respektojnë standardet etike dhe rregullat e sjelljes?



Duke iu referuar grafikut 2, më sipër, është e qartë se është e nevojshme të ndërtohet dhe forcohet besimi i qytetarëve duke përcaktuar dhe promovuar parimet etike, standardet e sjelljes dhe veprimet që priten nga deputetët në kryerjen e detyrave të tyre.

³ Të anketuarit i shprehin këto pikëpamje kur nuk mund të pajtohen plotësisht ose pjesërisht me një deklaratë pozitive ose negative. Kjo nuk tregon se nuk e dinë, ose se nuk kanë mendim në lidhje me pyetjen, por se nuk mund të japin notë pozitive sepse nuk pajtohen, përkundrazi, nuk mund të japin notë negative sepse nuk janë plotësisht të bindur.



Përgjigjet e të anketuarve të marra parasysh përmes prizmit të karakteristikave demografike tregojnë se ata që pohuan se deputetët *nuk respektojnë* standardet dhe kodet e sjelljes, *zakonisht janë burra, maqedonas etnikë, me arsim fillor dhe bëjnë pjesë në grup-moshën "mbi 55 vjeç"*. Në anën tjetër, përkundër faktit se të dhënat e grumbulluara tregojnë se *vetëm 12% e qytetarëve besojnë se deputetët respektojnë standardet dhe kodet e sjelljes, ata zakonisht i përkasin grup moshës më të re, nga vendbanim urban (urban 14%; rural 10%) dhe me arsim të lartë*.

Tabela 1. Në përgjithësi, sa mendoni se deputetët në vendin tonë respektojnë standardet etike dhe rregullat e sjelljes?

	Gjinia		Moshë			Përkatësia etnike		
	Mashkull	Femër	18-34	35-54	Mbi 55 vjeç	Maqedonas	Shqiptarë	Të tjerë
Mosrespektim	66%	60%	57%	62%	70%	66%	56%	64%

	Arsimi			Vendi i banimit	
	Fillor	Të mesëm	Të lartë	Urban	Rural
Mosrespektim	70%	62%	58%	62%	66%

	Gjinia		Moshë			Përkatësia etnike		
	Mashkull	Femër	18-34	35-54	Mbi 55 vjeç	Maqedonas	Shqiptarë	Të tjerë
Respektim	13%	12%	17%	13%	9%	12%	16%	9%

	Arsimi			Vendi i banimit	
	Fillor	Të mesëm	Të lartë	Urban	Rural
Respektim	7%	11%	21%	14%	10%


Në pyetjen tjetër, qytetarët patën mundësi të veçojnë një prioritet të deputetëve, nga 5 opsione. Siç shihet në Grafikon 3 më poshtë, 50% e të anketuarve theksuan se *mbajtja e premtimeve ndaj qytetarëve* duhet të jetë prioriteti kryesor i deputetëve. Të anketuarit e papunë dhe të anketuarit vetëm me arsim fillor dhanë këtë përgjigje në një masë më të madhe se të anketuarit që janë të punësuar dhe/ose kanë arsim të mesëm ose të lartë. Duke shqyrtuar përgjigjet përmes përkatësisë gjinore, vërehet se kjo përgjigje zgjidhet më shpesh nga gratë sesa burrat (burrat 47%; gratë 52%).



16% e të anketuarve besojnë se deputetët duhet t' i japin përparësi *shtypjes së korrupsionit* dhe të sigurojnë që paratë publike të shpenzohen në mënyrë racionale, me përgjegjësi dhe me kosto efektive. *Shqetësimi se si shpenzohen paratë publike përmendet më shpesh nga burrat sesa gratë (burrat 18%; gratë 13%), më shpesh nga banorët nga zonat urbane të banimit (burrat 17%; gratë 13%), nga ata me arsim të lartë (18%) krahasuar me personat me arsim fillor (12%) dhe arsim të mesëm (16%) dhe të punësuarit në sektorin publik (20%) krahasuar me sektorin privat (16%).* Margjina më e vogël e të anketuarve (8%) deklaruan se prioriteti i parë i deputetëve duhet të jetë balancimi i nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve nga grupe të ndryshme shoqërore dhe ndikimi i procesit legjislativ sipas prioriteteve të qytetarëve.

Përgjigja se deputetët duhet të sigurojnë që paratë publike të shpenzohen në mënyrë racionale dhe me kosto efektive u shpreh më shpesh nga burrat nga zonat urbane të banimit, si dhe nga ata me arsim të lartë dhe që janë të punësuar në institucionet e sektorit publik.

Grafiku 3. (P3) Cila nga të pohimet duhet të jetë prioritet në punën e deputetëve në vendin tonë?



Duke pasur parasysh këto gjetje, qytetarët besojnë se vlerat dhe standardet që duhet të përcaktojnë sjelljen e deputetëve janë *përkushtimi ndaj interesit publik, ndjekjes së qëllimeve zhvillimore të vendit, si dhe mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të të gjithë qytetarëve dhe subjekteve në komunitet, të cilat gjithmonë duhet të rezultojnë nga programe dhe premtime specifike politike që politikanët u japin qytetarëve.* Në fakt, këto fusha janë përcaktuar sipas objektivave të parashikuara në udhëzimet për reformimin e sistemeve parlamentare të etikës nga OSBE, ODIHR⁴ si dhe UIP 2022 indikatorët për Kuvend të Përgjegjshëm dhe Transparent⁵.

⁴ Background Study: Professional and Ethical Standards for Parliamentarians, Warsaw, 2012, n. 18, <https://www.osce.org/odihr/98924>


⁵ Indicators for democratic parliaments, based on SDG targets 16.6 and 16.7. Preliminary version, April 2022 by Inter-Parliamentary Union. <https://www.ipu.org/file/14426/download>



Në kryerjen e detyrave të tyre, nga deputetët pritet të respektojnë rregullat që kanë të bëjnë me ndalimin e korrupsionit dhe të mos përdorin pozitën e tyre për përfitime materiale dhe/ose jo materiale. Përveç kësaj, deputetët pritet të sillen me përgjegjësi me mjetet financiare dhe materiale, pajisjet dhe burimet e tjera të institucionit, dhe t'i përdorin burimet në mënyrë racionale dhe efikase, dhe vetëm për nevojat e kryerjes së funksionit të tyre parlamentar.

Pyetja tjetër në sondazh theksoi karakteristikat ideale personale të një deputeti. Të anketuarit kryesisht theksuan se karakteristika më e rëndësishme për një deputet të parlamentit është të jetë i pa korruptuar, por sipas gamës së përgjigjeve (Grafiku 4) të gjitha tiparet e paraqitura duket se përmenden si të rëndësishme për një deputet. Duke marrë parasysh përgjigjet në lidhje me karakteristikat më të rëndësishme të një deputeti dhe demografinë e të anketuarve, vërehet se nevoja për të qenë "i pakorruptueshëm" është theksuar më shpesh nga maqedonasit etnikë në raport me bashkësitë e tjera etnike dhe nga ata me arsim të lartë.

Grafiku 4. (P4) Sipas Ju, cilat janë karakteristikat më të rëndësishme të një deputeti?





Kjo nënkupton që deputetët pritet të *raportojnë çdo veprim që lidhet me korrupsionin dhe të mos ndërmarrin veprime që mund t'i lidhin me ekzistencën e korrupsionit (për shembull, pranimiti i dhuratave). Deputetët pritet të jenë të hapur dhe transparentë ndaj qytetarëve dhe gjithmonë të shfrytëzojnë dhe shpërndajnë informata të vërteta, të përshtatshme, në kohë dhe të plota.*

Më poshtë, në Grafikon 5, të dhënat tregojnë se rreth 31% e qytetarëve mendojnë se “komunikimi më i shpeshtë” me publikun mund të rrisë efikasitetin e deputetëve në punën e tyre. Gjegjësisht, në lidhje me pyetjen, “si mund ta ushtrojnë deputetët punën e tyre në mënyrë më efikase?”, të anketuarit në masë të madhe u përgjigjën “përmes komunikimit më të shpeshtë me qytetarët”. Këto rezultate nga të dhënat tregojnë nevojën për komunikim më të shpeshtë midis deputetëve dhe qytetarëve. “Debati rrënjësor dhe i informuar në Kuvend” dallohet si rruga e dytë për *efikasitet më të madh në punën e deputetëve*. Përafërsisht 18% e të anketuarve besojnë se debatet duhet të jenë një dukuri e shpeshtë në Kuvend.

Për më tepër, puna e përbashkët e deputetëve me partitë politike për çështje që janë me *rëndësi të madhe për qytetarët është përgjigjja e tretë që mund të përmirësojë efikasitetin e punës së deputetëve (17%).*

Nëse i shqyrtojmë përgjigjet përmes prizmit të karakteristikave demografike (Tabela 2), të dhënat mbështesin konstatimin se qytetarët me *arsim të lartë* përgjigjen më **qartë se, për të kryer punën e tyre** në mënyrë **më efikase**, “deputetët duhet të marrin pjesë në debate të hollësishme dhe të informuara”, ndërsa qytetarët me arsim të ulët më shpesh theksojnë se *deputetët duhet të komunikojnë me qytetarët*. Sugjerimi se, për të rritur efikasitetin në punë, deputetët duhet të komunikojnë më shumë me qytetarët, vërehet më shpesh në përgjigjet e të papunëve dhe pensionistëve.

Përveç kësaj, maqedonasit etnikë, në krahasim me pjesëtarët e bashkësisë etnike shqiptare, në mënyrë të konsiderueshme më shpesh i japin përparësi komunikimit të deputetëve me qytetarët.

Burrat (39%) pak më shpesh se gratë (35%), si dhe anëtarët e grup-moshës “mbi 55 vjeç” dhe qytetarët me arsim të lartë, theksojnë se përmes punës së përbashkët me partitë politike për çështje që janë me rëndësi të madhe për qytetarët, deputetët mund ta bëjnë punën e tyre në mënyrë më efikase.




Tabela 2. Përmes punës së përbashkët me partitë, deputetët mund ta bëjnë punën e tyre në mënyrë më efikase

Gjinia		Mosha		
Mashkull	Femër	18-34	35-54	Mbi 55
39,0%	35,4%	31,6%	37,6%	40,9%

Arsimi			Vendbanimi	
Fillor	Të mesëm	Të lartë	Urban	Rural
36,0%	36,2%	40,6%	35,3%	40,2%

Grafiku 5. (P5) Sipas ju, si mund ta ushtrojnë deputetët punën e tyre në mënyrë më efikase?



Vlerat dhe parimet themelore etike⁶, ndër të tjera, tregojnë se deputetët pritet të jenë të hapur në komunikim me votuesit dhe qytetarët në mënyrë që të kultivojnë një kulturë pune ku qytetarët mund të kenë qasje më të lehtë në informacione dhe të dhëna për punën e tyre dhe se deputetët duhet të shprehin pikëpamjet dhe mendimet e tyre në mënyrë të hapur, të qartë, koncize dhe pa dykuptimësi.

⁶ Common Ethical Principles Members Of Parliament, NDI, [https://www.ndi.org/sites/default/files/Common%20Ethical%20Principles%20ENGLISH%20\(1\).pdf](https://www.ndi.org/sites/default/files/Common%20Ethical%20Principles%20ENGLISH%20(1).pdf)




Qytetarët, kur pyeten për sfidat me të cilat përballen më shpesh deputetët gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, më së shpeshti theksojnë (Grafiku 6) se deputetët përballen me “presione nga partitë politike”. Gjithsej 42.3% e qytetarëve besojnë se deputetët *përballen me “presion nga partitë politike” në ushtrimin e detyrave të tyre*. Qytetarët kanë tre herë më pak gjasa të sugjerojnë vështirësitë që deputetët hasin në komunikimin e tyre me qytetarët. Në këtë drejtim, deputetët po përballen me nevojën për përpjekje plotësuese për të arritur komunikim të pandërprerë dhe më të shpeshtë me qytetarët.

12% e të anketuarve deklaruan se nuk ka praktikë në vendosjen e masave disiplinore për mosrespektimin e kodeve të sjelljes dhe kodeve të etikës. E njëjta përqindje e të anketuarve theksuan se mungesa e përvojës dhe njohurive të deputetëve është një sfidë që i pengon deputetët në ushtrimin e detyrave të tyre. Vetëm 5% e të anketuarve theksuan se deputetët nuk kanë burime të mjaftueshme për punë dhe përballen me vështirësi në respektimin ose inkurajimin e respektimit të standardeve etike. Përgjigjet e 4.9% të qytetarëve zbulojnë se qytetarët nuk janë të informuar për vështirësitë e tjera me të cilat përballen deputetët në lidhje me respektimin ose harmonizimin me standardet etike.

Sa i përket dallimeve në përgjigje sa i përket karakteristikave demografike, burrat (46%) në krahasim me gratë (39%) theksojnë më shpesh se “presionet e partive politike” janë sfida më e madhe me të cilën përballen deputetët. Përveç kësaj, këto përgjigje janë pothuajse dy herë më të shpeshta në mesin e maqedonasve etnikë në krahasim me anëtarët e bashkësisë etnike shqiptare. Përkundrazi, shqiptarët etnikë, më shpesh se maqedonasit etnikë, theksojnë se “deputetët nuk kanë përvojë dhe njohuri në ushtrimin e detyrave të tyre”. Të anketuarit me arsim fillor, më shpesh se qytetarët me arsim të lartë, treguan se deputetët kanë vështirësi në mirëmbajtjen e bashkëpunimit me qytetarët.



Grafiku 6 (P6) Sipas mendimit tuaj, me cilat sfida përballen më shpesh deputetët gjatë ushtrimit të detyrave të tyre?



Kuadri për sjelljen e rekomanduar dhe të dëshirueshme të deputetëve përcakton se ata duhet të veprojnë në mënyrë të paanshme, pa paragjykime dhe pa qëllim të përfitimit personal. Gjatë marrjes së vendimeve, deputetët priten të veprojnë vetëm në bazë të ndjenjave, besimeve dhe bindjeve personale, për të mos përjashtuar këndvështrime të ndryshme, por për t'i marrë ato parasysh dhe për të siguruar që vendimet të merren bazuar në fakte.

Qytetarët u pyetën se në çfarë mase mendojnë se deputetët herë pas here sillen jashtë standardeve, që është në kundërshtim me normat dhe standardet që janë të rregulluara në Kodin Etik. Nga 18 mënyrat e paraqitura të sjelljes (Tabela 3), të anketuarit kryesisht u përgjigjën se "kurrë" ose "rrallë" deputetët sillen në përputhje me standardet e etikës dhe sjelljes. Për më tepër, rreth 80% e të anketuarve pajtohen se "kurrë ose rrallë":

- Deputetët pranojnë gabimet e tyre dhe marrin përgjegjësi për veprimet e tyre;
- Sigurohen që paratë publike të shpenzohen në mënyrë të drejtë;
- Sillen në mënyrë të përgjegjshme dhe me kosto efektive me mjetet dhe burimet që vendosen në dispozicion të tyre;
- Mbjajnë premtimet që i japin gjatë fushatës zgjedhore; dhe
- Paraqesin shembull të mirë për qytetarët e tjerë.

Nga rezultatet është e qartë se qytetarët presin të krijohen mekanizma të përshtatshëm që do të mundësojnë zbatimin praktik të sanksioneve për mosrespektimin e ligjeve ose parimeve dhe vlerave



